



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:275465

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05354418

KPPP.nr.1778/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit KRU “Hidromorava” Sh.A. me seli në Gjilan, kundër debitorit Restaurant “Konaku” me seli në Kamenicë fshati Berivojcë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 395/2021 të datës 11.11.2021, të lëshuar Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa me seli të zyrës në Gjilan, jashtë seancës, me datë 21.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Restaurant “Konaku” ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr. 395/2021 i datës 11.11.2021, i lëshuar Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 1,321.08 EUR, dhe në këtë pjesë të përbarimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuarprapësimi i debitorit Restaurant “Konaku” ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përbarimor P.nr. 395/2021 të datës 11.11.2021, të lëshuar Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, sa i përket detyrimit në vlerë prej 77.12 EUR.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KRU “Hidromorava” Sh.A. me datë 11.11.2021 ka caktuar urdhrin P.nr.395/2021, te datës 11.11.2021 duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit faturë e datës 30.09.2021 të cilës i është bashkangjitur kartela e konsumatorit për periudhën 2009 deri në vitin 2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në

emër të borxhit të papaguar për shërbimet e furnizimit me ujë, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,398.20 EUR (me shkronja: njëmijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë euro e njëzet euro cent) si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit me arsyetimin se propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore sepse nuk është pranuar nga debitori, si dhe ka shtuar se ky borsh është parashkruar sipas LMD-se.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, për faktin se në rastin konkret debitori ka bërë pagesa të vazhdueshme në emër të konsumit të ujit për periudhën andaj përmes pagesave në fjalë, i njëjti ka pohuar borxhin në tërësi, që për pasojë sjell ndërprerjen e parashkrimit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet dhe Urdhri për lejimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, me aktvendimin PPP.nr. 29/2021 të datës 30.06.2022, ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar pjesërisht urdhrin përmbartimor P.nr. 395/2021 të datës 11.11.2021 për shumën prej 1,372.92 EUR për shkak të parashkrimit të kërkesës. Ndërsa në pikën dy të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr. 395/2021 të datës 11.11.2021 për shumën prej 25,28 EUR.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 410/23 të datës 05.09.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit ashtu që ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë PPP.nr. 29/2021 të datës 30.06.2022, dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet e dhëna nga Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate sipas aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 410/23 të datës 05.09.2023, në mbështetje të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje si LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-paragrafin 1.2 të këtij neni, si dokumente të besueshme paraqiten *“ ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”* kurse me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e borxhit, gjykata gjeti se borxhi që rrjedh nga dokumenti fatura-kartela e konsumatorit me nr. 17666 është përfshirë pjesërisht në parashkrim, për shkaqet si në vijim:

Me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*.

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, Gjkata gjen se kërkesat e kreditorit për shërbimet nga data 31.01.2014 e deri me datën 08.11.2018 të cilat arrijnë vlerën prej 1,321.08 EUR kanë arritur afatin e parashkrimit, pasi që lidhur me borxhin që rrjedh nga këto shërbime, propozimi i kreditorit për përmbarim është paraqitur me datë 09.11.2021, më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit të tyre për pagesë.

Andaj Gjkata gjeti se prapësimi i debitorit në raport për këtë pjesë të borxhit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, par.1, nën-par 1.10 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore i cili përcakton se: *“1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve”*, andaj edhe u vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi, që urdhri përmbarimor P.nr. 395/2021 i datës 11.11.2021 për shumën prej 1,321.08 EUR të shfuqizohet.

Ndërsa, vendimi mbi përfundimin e procedurës përmbarimore në këtë pjesë të përmbarimit Gjkata e morri duke u bazuar në nenin 66.4 të LPP-së i cili përcakton se *“Përmbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarim”*.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përbarimor P.nr. 395/2021 i datës 11.11.2021 për borxhin në vlerë prej 77.12 EUR, pasi që Gjykata gjeti se borxhi në fjalë, i referohet periudhës kohore nga data 09.11.2018 e deri më datë 30.09.2021, e meqenëse propozimi për përbarim është paraqitur me datë 09.11.2021, Gjykata erdhi në përfundim se borxhi lidhur me shërbimet e ofruara për gjatë kësaj periudhë kohore nuk ka arritur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e kreditorit se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndërprerje të afatit të parashkrimit pasi që debitori ka bërë vazhdimisht pagesa, vërejtje kjo e dhënë edhe nga ana e Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, por që në rastin konkret, gjykata gjen se pagesat e realizuara nga debitori nuk evidentohen si pagesa lidhur me ndonjë faturë konkrete, kjo pasi që vlera e secilës pagesë është më e madhe se vlera e secilës faturë.

Në lidhje me këtë, me nenin 293 par.1 të LMD-së përcaktohet se *“Kur midis personave të njëjtë ekzistojnë disa detyrime të njëllota, kështu që atë që debitori e përmbush nuk mjafton për t’i plotësuar të gjitha, atëherë, në qoftë se për këtë gjë nuk ekziston marrëveshja e kreditorit dhe debitorit, llogaritja bëhet me atë radhë të cilën e cakton debitori më së voni me rastin e përmbushjes”*, në lidhje me paragrafin 2 të këtij neni i cili parasheh se - *“Kur nuk ekziston deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje”*.

Në mbështetje të dispozitave të lartcekura, gjykata vlerëson se pagesat e realizuara nga ana e debitorit të cilat nuk kanë përmbajtur deklaratën mbi llogaritjen e borxhit, konsiderohen se kanë përmbushur detyrimet më të hershme të cilat janë maturuar për pagesë, ndërsa borxhi i mbetur në fuqi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi përfshin periudhën e faturave që kanë arritur më vonë për pagesë, e për të cilat nuk evidentohet ndonjë pagesë specifike. Rrjedhimisht, pagesat e bëra për borxhet paraprake nga debitori nuk mund të mirën si bazë për ndërprerjen e afatit të parashkrimit edhe për pagesat e mëvonshme të arritura për pagesë të cilat nuk e kanë arritur afatin e parashkrimit, kjo sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesa të natyrës periodike, ku afati i parashkrimit rrjedh për çdo kërkesë-faturë veç e veç.

Andaj, në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13

par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1778/23, datë 21.02.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.